

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 30.12.2020, solli

MENDIM

Propozim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën e Maqedonisë për mbështetje zhvillimore, me të cilin planifikohet të vendoset skema shtetërore e garancisë përmes Bankës për Zhvillim të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke formuar një Fond Garancie, i cili nëpërmjet dhënies së garancisë do të ndihmojë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në financimin e pandërprerë të aktiviteteve aktuale dhe nevojën për kapital qarkullues, sipas Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, paraqet skemë ndihme që duhet të harmonizohet me Shënimin e Komisionit Evropian për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Marrëveshjes së Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore në formën e garancive Commission Notice on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to State aid in the form of guarantees – EUR-Lex – 52008XC0620(02) – në tekstin e mëtejshëm- Shënim).

Harmonizimi me Shënimin në mënyrë të veçantë i referohet pjesëve të mëposhtme të Propozim-ligjit:

- garancia shtetërore nënkupton se do të ofrohet për ndërmarrjet që plotësojnë kushtet, tek të cilat ekziston një vlerësim kredie dhe mundësi vlerësimi të rrezikut, pastaj për një periudhë të kufizuar kohore dhe për një shumë të caktuar maksimale. Garancitë e pakufizuara janë jokompatibile me nenin 87 të Marrëveshjes së BE-së.
- neni 13-g paragrafi (2) i Propozim-ligjit, i cili përcakton se përfitues të garancive mund të jenë NMVM-të, si dhe tregtarët e mëdhenj që kryejnë eksporte të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është në kundërshtim me pikën 1.3 të Shënit.
- në varësi të saj nëse bëhet fjalë për garanci individuale apo skema garancie, duhet vlerësuar nëse kushtet e përcaktuara në pikën 3.2 janë (jo) të pranishme. (garanci individuale) dhe 3.4. (skemat e garancisë) të Shënit për të përcaktuar nëse ekziston ose jo ndihmë shtetërore në garancitë e lëshuara. Nisur nga kjo, në skemat individuale, plotësimi i kushteve të përcaktuara në pikën 3.2. nga Shënimi nënkupton mungesën e ndihmës shtetërore për garancinë e dhënë shtetërore dhe këto janë: a) ndërmarrja të mos jetë në vështirësi financiare; b) vëllimi i garancisë mund të matet saktë në momentin që jepet (garancia duhet të lidhet me një transaksion të caktuar financiar, për një shumë maksimale fikse dhe të kufizuar në kohë); c) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huas së pashlyer ose mjeteve të tjera financiare (ashtu si do të zvogëlohet borxhi dhe garancia të mos mbuloj më shumë se 80% të huas së mbetur ose detyrimit financiar, por edhe mbulimin proporcional të humbjeve ndërmjet

huadhënësit dhe shtetit); e) garancia e dhënë duhet të kompensohet me një premi të përshtatshme.

Ndërsa te **skemat e garancisë** (pika 3.3. e Shënimit) plotësimi i kushteve të mëposhtme do të përjashtojë praninë e ndihmës shtetërore: a) skema të mos u mundësohet debitorëve që kanë vështirësi financiare; b) vëllimi i garancive mund të matet saktë në momentin e dhënies së tyre (garancitë duhet të lidhen me transaksione financiare specifike, për një shumë maksimale fikse dhe të kufizuar në kohë); c) garancitë nuk mbulojnë më shumë se 80% të çdo huaje të papaguar ose detyrime të tjera financiare; d) kushtet e skemës bazohen në një vlerësim real të rrezikut në mënyrë që premitë e paguara nga përfituesit ta bëjnë atë të vetëfinancuar; e) rregullimin e premive në mënyrë që të ketë një vlerësim adekuat dhe progresiv në aspektit vetëfinancimit të skemës; f) për t'u trajtuar si treg, premitë që paguhet duhet të mbulojnë rreziqet normale që lidhen me dhënien e garancisë, kostot administrative të skemës dhe kompensimin vjetor të kapitalit përkatës.

Në përgjithësi, në Shënim thuhet se nëse bëhet fjalë për një garanci individuale ose një skemë garancie, nëse garancia e lëshuar nga shteti nuk nënkupton ndonjë përfitim për ndërmarrjen, ajo nuk do të paraqet ndihmë shtetërore.

- Vlerësimi i skemave të garancisë për NVM-të (pika 3.5 e Shënimit) dhe mënyra e përcaktimit të premive

Pas harmonizimit me Shënimin, Ministria e Financave ka për obligim që të dorëzojë Ligjin tashmë të miratuar (me të cilin është ndryshuar dhe plotësuar Ligji themelor për Bankën e Maqedonisë për të mbështetur zhvillimin) si dhe formularin e plotësuar Njoftimi për dhënien e planifikuar të ndihmës në pajtim me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për dorëzimin e njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 142/11).

Pas përmbushjes së këtij detyrimi ligjor të Ministrisë së Financave, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës do të fillojë me shqyrtimin e Njoftimit të dorëzuar dhe vlerësimin e masës nëse ai paraqet ndihmë shtetërore, me ç ‘rast do të marrë një Vendim për këtë.

Për shkak të vlerësimit të masës nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ministria e Financave në Njoftim duhet të japë të dhëna dhe informacione në lidhje me intensitetin e ndihmës, karakteristikat e përdoruesve dhe qëllimet që ndiqen për zbatimin e masave të tilla të parashikuara në Propozim-ligj. Të dhëna të tilla do t'i mundësojnë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të vlerësojë efektet e masës së propozuar për të vendosur një skemë garancie, por edhe për të përcaktuar nëse masa e planifikuar nënkupton ndihmë de minimis për shkak të shumës së vogël të ndihmës.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски